

# EDUKIMI LIGJOR PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR PROFESIONISTET E SË DREJTËS



## HELP

Programi Evropian  
për të Drejtat e Njeriut  
Edukimi Ligjor  
për profesionistët e së drejtës

Financuar nga Trusti  
për të Drejtat e Njeriut  
dhe Këshilli i Evropës

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

# PROGRAMI HELP

Programi Evropian për të Drejtat e Njeriut Edukimi Ligjor për Profesionistët e së Drejtës (HELP) mbështet Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës (KE) në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) në nivel kombëtar, bazuar në Rekomandimin e Komitetit të Ministrave (2004)4, në Deklaratën e Brajton-it të vitit 2012 dhe në Rezolutën 1982 (2014) të Asamblesë Parlamentare.

Kjo është realizuar duke rritur kapacitetet e gjyqtarëve, avokatëve dhe prokurorëve në të 47 Shtetet Anëtare për të zbatuar KEDNj në punën e tyre të përditshme.

## RRJETI I HELP

Rrjeti HELP është i përbërë nga përfaqësues të institucioneve kombëtare të trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe shoqatat e avokatëve të 47 Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës. Ky është një Rrjet në nivel ekspertësh për Trajnimin për të Drejtat Evropiane të Njeriut, i cili mbledhet çdo vit për të ndarë praktikat më të mira, për të ofruar sugjerime dhe për të miratuar një plan të çështjeve prioritare që do të trajtohen në kurrikulat dhe materialet e HELP në të ardhmen.

## BORDI KESHILLIMOR I HELP

Bordi Këshillimor i HELP është organ i emëruar nga Rrjeti HELP me qëllim që të sigurojë mbështetje të vazhdueshme në këshillimin e Sekretariatit të HELP.

Bordi përbëhet nga gjashtë anëtarë të cilët emërohen nga radhet e përfaqësuesve të Rrjetit HELP.

## MATERIALET E TRAJNIMIT TE HELP

■ Faqja e internetit HELP është një platformë ku gjenden materiale burimore për mësimin në distancë dhe mësimin individual, lidhur me KEDNj dhe standardet evropiane të të drejtave të njeriut.

■ Materialet e mësimin në distancë janë të vlefshme për grupet e përzgjedhura të profesionistëve ligjorë që marrin pjesë në kurset pilot që drejtohen nga trajnerët kombëtare.

■ Materialet e trajnimeve individuale mund të aksesohen nga çdo përdorues, duke krijuar një llogari në faqen e internetit <http://help.ppa.coe.int/login>. Materialet e trajnimit për çdo nen të KEDNj, si dhe tema të veçanta për të drejtat e njeriut janë në dispozicion në gjuhë të ndryshme.

■ Bordi Editorial i HELP është përgjegjës për përditësimin dhe sigurimin e cilësisë së materialeve të trajnimit.

■ Materialet mbi temat e mëposhtme janë tashmë në dispozicion:

- ▶ Kriteret e pranueshmërisë në kërkesat e paraqitura në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut
- ▶ Çështjet e Anti-diskriminim
- ▶ E drejta për azil dhe KEDNj
- ▶ Biznesi dhe të drejtat e njeriut
- ▶ Prekursorët (*shenjat parandaluese*) kimike
- ▶ Sanksionet e komunitetit dhe masat alternative të paraburgimit
- ▶ Falsifikimi i produkteve mjekësore dhe krimet kundër shëndetit publik
- ▶ E drejta familjare dhe drejtësia 'favorizuese' për të miturit
- ▶ Krimi i urrejtjes dhe gjuha e urrejtjes
- ▶ Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet penale
- ▶ Hyrje në KEDNj
- ▶ Trafikimi i qënieve njerëzore

## PIKAT E KONTAKTIT 'FOCAL' DHE 'INFO'

■ Për të forcuar Rrjetin e HELP, janë caktuar ekspertë kombëtarë që të mbajnë kontakte dhe lidhje mes institucioneve përkatës në nivel kombëtar dhe Sekretariatit të HELP, si dhe për të shpërndarë materialet e hartuara nga HELP gjatë aktiviteteve kombëtare. Personat/Pikat e Kontaktit 'Focal' ndërlidhen dhe bashkëpunojnë me institucionet kombëtare të trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kurse Personat e Kontaktit 'Info' me Dhomat e Avokatisë.

## FAQJA E INTERNETIT HELP NE 47 VENDE

■ Informacionet lidhur me Trajnimet e HELP për të gjithë profesionistët në fushën e së drejtës në të 47 Shtetet Anëtarët të Këshillit të Evropës, gjenden në faqen e internetit HELP në 47 (<http://www.coe.int/help>).

■ Informacionet e HELP për shtete të veçanta si dhe për aktivitete që lidhen me zbatimin e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar gjenden në Faqet Kombëtare të HELP, dhe përditësohen nga Personat e Kontaktit 'Focal' dhe 'Info'.

## METODOLOGJIA E HELP

■ Metodologjia e programit të trajnimit të HELP, bazuar në parimin e edukimit të hapur, merr parasysh presionin për kohën e pakët në dispozicion të profesionistëve ligjorë.

■ Materialet e trajnimit hartohen nga ekspertë ndërkombëtarë dhe pastaj përshtaten me rendin ligjor të çdo shteti. Për këtë arsye, materialet dhe trajnimet përmbushin nevojat specifike për trajnim të profesionistëve ligjorë dhe krijojnë fleksibilitet.

## FONDI TRUST PER TE DREJTAT E NJERIUT

Programi HELP financohet kryesisht nga Fondi për të Drejtat e Njeriut (HRTF).

Fondi u ngrit në mars të vitit 2008 nga Norvegjia, shteti iniciator dhe kontribues themelor, nga Këshilli i Evropës dhe nga Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës. Që nga krijimi i tij, HRTF i janë bashkuar Gjermania, Hollanda, Finlanda, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar.

## PARTNERET E HELP

- ▶ Rrjeti Evropian për Trajnime Gjyqësore
- ▶ Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve
- ▶ Këshilli i Dhomave dhe Shoqatave të Drejtësisë të Evropës
- ▶ Federata e Dhomave të Avokatëve Evropianë
- ▶ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- ▶ Shoqatat kombëtare të gjyqtarëve dhe prokurorëve
- ▶ Shoqatat profesionale të avokatëve, rrjetet e ndihmës ligjore dhe klinikat ligjore të specializuara në të drejtat e njeriut
- ▶ Fondacioni Mémoire Albert Cohen

## KËSHILLI I EVROPËS

Drejtorja e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit të së Drejtës

Drejtorja e të Drejtave të Njeriut

Departamenti i të Zhvillimit të Politikave për të Drejtat e Njeriut

Njësia për Mbështetjen e Zbatimit në Nivel Kombëtar të të Drejtave të Njeriut

[www.coe.int/help](http://www.coe.int/help)

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, 28 prej të cilëve janë shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE